



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Agjencia Kundër Korrupsionit
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: _____
 Dep: _____
 Dep: _____
 Nr. llog: _____
 Broj. stranica: _____
 Broj. list: _____

Nr Prot: _____
 Br Prot: _____
 Prot No: 03-02/3575/17
 Data: 30-10-2017
 Datum: 30-10-2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2524/17, për znj. Suzana Mustafaj, Drejtoresh për Buxhet dhe Financa në Komunën e Deçanit, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Suzana Mustafaj, Drejtoresh për Buxhet dhe Financa në Komunën e Deçanit dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Mustafaj është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese zyrtarja e lartë është njoftuar me fakte se ushtrimi i funksionit menaxhues në biznes privat është i ndaluar neni (15 paragrafi 1) të Ligjit nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3398/17) me të cilën dëshmohet se znj. Mustafaj është larguar nga funksioni “person i autorizuar” në biznesin privat N.N. “Lisi i Dashinocit”. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

